



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale

Independent Commission for Mines and Minerals



Në pajtim me nenin 56, paragrafi 1 pika 1.2, nenin 59 paragrafi 1, nenit 62, të ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, nenit 9 paragrafi 1.7 te Ligjit Nr. 04/L-158 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe në pajtim me Ligjin për Rrugët 2003/11, Bordi i Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralet në mbledhjen e mbajtur më datën 16.12.2013 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

PËR DISTANCAT NË RAPORT ME RRUGËT DHE SISTEMIN E SHFRYTEZIMIT MINERAR

(KPMM NR. 03/2014)

Neni 1 Qëllimi

Rregullimi, përcaktimi i distancave adekuate ndërmjet rrugëve dhe vend shfrytëzimit apo vend punishteve të sektorit minerar.

Neni 2 Kriteret

1. Kriteri për përcaktimin e distancave përcaktohet në pajtim me nenin 9 paragrafi 1.7 te Ligjit Nr. 04/L-158 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe në pajtim me ligjin nr. 2003/11, Për Rrugët, përkatësisht nenin 4 të këtij ligji..

Neni 3 Kategorizimi i Rrugëve

3.1. Rrjeti i rrugëve që i referohet ky udhëzim administrativ përbëhet nga:

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

- a) Autoudha
- b) Rrugët nacionale
- c) Rrugët regjionale
- d) Rrugët lokale
- e) Rrugët ne vendbanimeve
- f) Rrugët urbane
- g) Rrugët lidhëse dhe
- h) Rrugët te pa kategorizuar.

Neni 4

Distancat e lejuara sipas kategorisë së rrugëve

- 4.1.1 Me rastin e lëshimit të Licencës ose Lejes distanca e aktivitetit minerar nga Autoudha duhet të jetë 100 metra për aktivitet minerar pa minim, ndërkaq 500 m për aktivitet minerar me minim.
 - 4.1.2. Distanca nga rruga Nacionale, duhet të jetë 60 m me aktivitet minerar pa minim, ndërkaq 500 me aktivitet minerar me minim.
 - 4.1.3. Distanca nga rruga Lokale, duhet të jetë 60 m me aktivitet minerar pa minim, ndërkaq 500 me aktivitet minerar me minim.
 - 4.1.4 Distanca nga rruga e Vendbanimeve, duhet të jetë 60 m me aktivitet minerar pa minim, ndërkaq 500 me aktivitet minerar me minim.
 - 4.1.5. Distanca nga rruga Urbane, duhet të jetë 60 m me aktivitet minerar pa minim, ndërkaq 500 me aktivitet minerar me minim.
 - 4.1.6.. Distanca nga rruga Lidhëse, duhet të jetë 60m me aktivitet minerar pa minim dhe me minim.
 - 4.1.7. Distanca nga rruget e Pa kategorizuara, duhet të jetë 10 m me aktivitet minerar pa minim dhe me minim.
-
- 4.2 Nëse bartësi i licencës ose lejes dëshiron të ushtroj veprimitari që janë të përfshira në Licencë ose Leje në ndonjë zonë, e cila është e ndaluar në bazë të paragrafit 4.1 të këtij Neni, bartësi i licencës ose Lejes duhet të sjellë dëshmi marrëveshje-pëlqim lidhur me ushtrimin e veprimtarisë në licence apo leje nga institucionet apo "Organi përgjegjës për rruge publike"

Neni 5
Mënyra e vlerësimit të Distancave të Rrugëve

- 5.1. Me rastin e përpunimit të çdo aplikacioni zyrtaret e autorizuar të KPMM-së janë të obliguar të bëjnë verifikimin e rrugëve në përputhje me nenin 3 të këtij Udhëzimi.
- 5.2. Pasi të bëhet verifikimi dhe vlerësimi përkatës i rrugës atëherë bëhet rekomandimi lidhur me kategorizimin e rrugës se në cilën kategori të rrugës bie aplikacioni, për të cilën zyrtaret e KPMM-së e jepin vlerësimin.

Neni 6
Hyrja ne fuqi

- 6.1. Ky udhëzim Administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Ramiz Krasniqi,
U.d. Kryesues i Bordit,
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale